



ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **OPERIMI ME TRENA I HEKURUDHAVE TË KOSOVËS "TRAINKOS" SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 10908-20-4910-2-2-1 & Nr. I brendshëm: TRKOS/20/52/221

Sa i përket tenderit për "Vlerësimi i aseteve të Trainkos Sha"

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

PRO ACC GROUP SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

RR. JAKOV XOXHA, NR. 341 LAM/ 25-1

(Adresa)

PRISHTINË

(Vendi)

10 000

(Kodi postar)

+38345 321 877

(Numri Telefonit)

N/A

(Numri i Faks-it)

BEHAR JANUZI

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

behar.januzi@gmail.com & behar.januzi@proaccgroup.com

(Adresa elektronike)

16.11.2020

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vulë)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtrojë ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me **PROKURË**.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 03.09.2020

Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara: 14.09.2020

Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 24.09.2020

Procesverbali i hapjes së DT. me: 29.09.2020

Njoftimi mbi vendimin e AK-së me: 03.11.2020

Kërkesa për Rishqyrtim me: 06.11.2020

Njoftimi për pezullim: 10.11.2020

Njoftimi për Vendimin e AK-së: 11.11.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Bazuar në nenin 108/A të LPP-se parashtrrojme kërkesë për rishqyrtim (paragrafi 3.1 kërkesë për rishqyrtim në fazën tenderuese që do të thote se kërkesa parashtrohet pas marrjes së vendimit për eliminim nga ana e AK-së si dhe pasë marrjes së Vendimit nga AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim)

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtejshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së.

Pasi kemi pranuar njoftimin për eliminim dhe e kundërshtojmë vendimin e AK-së. Me datën 06.11.2020 brenda afatit të rregullt ligjor kemi parashkuar Kërkesë për Rishqyrtim të Vendimit të AK-së.

AK ka shqyrtuar kërkesën tonë dhe me datën 11.11.2020 na ka derguar vendimin lidhur me këtë shqyrtim ku sipas këtij vendimit AK ka hedhur poshtë pretendimet tona dhe ka lënë në fuqi vendimin e marrur më herët.

Në përputhje me LPP-në dhe brenda afatit ligjor ne i drejtohemi OSHP-së me këtë ankesë kundër vendimit të AK-së.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

**Neni 59 i LPP-së Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tënderve.
Neni 72 të LPP-së.**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Kompania jone si kompani lider dhe me një eksperiencë shumë vjeqare për vlerësim dhe ri-vlerësim të pasurive dhe aseteve ka shprehur interesim që të marrë pjesë në këtë

aktivitet të prokurimit dhe me date: 03.09.2020 kemi terhequr dosjen e tenderit në platformen elektronike e-prokurimi.

Me datë: 23.09.2020 kemi dorzuar dhe DT.

Me datë 03.11.2020 kemi pranuar Letër standarde për tenderusin e eliminuar si dhe me datën 11.11.2020 kemi pranuar Vendimi për Refuzimin e kërkeses për rishqyrtim përmes platformës elektronike e-prokurimit ku thuhet se:

- Prendentimi i AK-së në letë për tenderusit e eliminuar: Sa i përket personit të prezantuar me numër rendor 1, mbi kërkesat e projekt menaxherit dhe përvojën e punës pas diplomimit.

Pergjigja e OE: Sa i përket, Menaxherin të Projektit, personi në fjalë Perovoja e punës i njëjet duke filluar nga data e Diplomimit në Fakultetin Ekonomik në Drejtimin Banka, Financa dhe Kontabilitet nga data; 18 Mars 2008, Nr. 515, dhe ka 10 vite eksperiencë.

Ndërsa sa i përket kriterit Ekonomist i Diplomuar, i njëjti e plotson kriterin e lartë permendur pasi që personi në fjalë e ka të përfunduar, Master në Fakultetin Ekonomik me Titull: Master për Banka, Financa dhe Kontabilitet, me datën: 8 korrik 2014 I ka të deshmuar dhe me Cy dhe Deklaratë me shkrim se personi në fjalë ka mbi 10 vite eksperienc pune (nga viti: 2008 deri me tani është me kontratë pune të rregullt), që të gjitha kanë qenë të ngarkuar në e-prokurim sipas numrit rendor, për të nejtën pika AK ka pasur mundësi të na kërkoj sqarime shitesë.

AK këtë pikë e ka hedhur poshtë me Vendim. Nr, 4911/2020

- Prendentimi i AK-së në letë për tenderusit e eliminuar te pika 2 per Asistent Menaxher i Projektit: Sa i përket personit të prezantuar me numër rendor 2, ju nuk e keni plotësuar kërkesat e dosjes se tenderit për Asistentin e Projekt menaxherit të diplomuar në fushën e financave apo kontabilitetit.

Pergjigja e OE: Sa i përket personit në fjalë është prezantuar **DIPLOMA** e Fakultetit ku personi në fjalë ka përfunduar **Studimet në Drejtimin Ekonomist i Diplomuar**. Me datë 21.03.1989 me Nr. 5145.(në atë kohë nuk ka pasur degë të ndara, vetëm Ekonomistë Diplomuar personi në fjalë ka përfunduar studimet para sistemit të bolonjës ku nuk ka pasur drejtime te ndara dhe ka marrë Titullin Ekonomist i Përgjithshëm për të gjitha lomit e ekonomise).

- Prendentimi i AK-së në Vendimin me Nr, 4911/2020 të datës 11.11.2020 per Asistentin e Projekt menaxherit:

OE duhet të caktojë një Asistent të projekt menaxheri i cili duhet të jetë i diplomuar në fushën e biznesit ndërkombëtar me provoj profesionale prej 5 viteve pas diplomimit në fushën e financave dhe duhet të jetë anëtar i ndonjë organizate të licencuar për kontabilitet publik.

Pergjigja e OE: Te pika e lart cekur te AK- së nuk qendron per arsye se AK me datën 14.09.2020 ka ndryshuar Dosjen e Tenderi përmes Njoftimit per Informata Shitesë ose Permiresim i Gabimit, pika 3 të Kapaciteti Teknik dhe profesional ku thuhet që:

OE duhet të caktojë një Asistent të projekt menaxheri i cili duhet të jetë i diplomuar në fushën e financave apo kontabilitetit me përvojë profesionale prej 5 viteve pas diplomimit ne fushën e financave dhe duhet te jetë anëtar i ndonjë organizate te licencuar për kontabilitet publik.

Përgjigja e OE: I njeiti ka të përfunduar SCAAK nga Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës, ku i njeiti person posedon Çertifikaten e anëtarësis në SCAAK, që të gjitha i ka dhe të dëshmuar me Cv dhe Vendim për Asistent i Projekt Menaxherit, ku kanë qënë të ngarkuar në e-prokurim sipas numrit vendor. Personi në fjalë ka mbi 5 vite kontratë pune (tejkalon eksperiencën e kerkuar) të rregullt në fushën e financave apo kontabilitetit publik.

Ne OE e kemi plotësuar këtë kriter ku dhe mund të shihet në të dokumentat e ngarkuar në e-prokurimi.

- Prendentimi i AK-së në letë për tenderusit e eliminuar: Sa i përket pikes tre (1,2) nga vendimi i AK ku thuhet se nuk e keni plotësuar kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, dhe **Vendimin me Nr. 4911/2020 të datës 11.11.2020** ku thuhet:

Përgjigja ne pretendim 3:

Kërkesa e D1:

1. Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë së paku dy referenca dhe raporte të vlerësimit për vlerësim të aseteve në kompani të mëdha me vlerë të aseteve minimum 3 milion Euro.
2. Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë së paku 2 referenca dhe raporte të vlerësimit për vlerësim të aseteve të kompanive të mëdha me garkullim jo më pak se 7.5 milion në tri vitet e fundit.

Ju keni ofruar listën e referencave për vlerësim të aseteve të kompanive me vlerë deri në 3 mln euro në të cilën nuk ka përfshirë asnjë vlerësim që bëhet për atë kompani por për banka që marrin kolateral nga huamarrësit që nuk është në përputhje me kërkesën e D1. Vlerësimi i kolateralit nuk është prone e bankës për të cilën është bërë vlerësimi por është e individëve që marrin kredi.

Dy kontratat GIZ dhe Hidroregjioni jugor nuk keni përfshirë në reference vlerën e aseteve.

Operatori Ekonomik nuk ka përfshirë referencën për vlerësimet e bashkangjitura në projektet KRU Prizreni, Prishtina dhe Gjakova

Prandaj si rezultat Autoriteti Kontraktues konstaton se ky pretendim është i pabazuar.

Ne si Autoriteti Kontraktues kemi përcaktuar në detale sipas kërkesave të UOPP detyrat dhe outputet të cilat duhet të zhvillohen në bazë të kërkesave të ToR.

Autoriteti Kontraktues poashtu ka kontaktuar pronarin e softwerit për menaxhimin e aseteve ku në listën e çmimeve është kërkuar të ipet çmimi për:

2	Implementimi dhe upgrade i sistemit të menaxhimit të aseteve bazuar në teknologjinë informative	KOMPLET	1	€ 177.97	€ 122.03	€ 800.00	€ 800.00	Kosova
---	---	---------	---	-------------	-------------	-------------	-------------	--------

Ju si Operator Ekonomik nuk keni marrë asnjë oferte nga kompania përgjegjëse apo nuk keni bërë asnjë analizë se si do të implementoni këtë pikë sikurse është kërkuar në terma të referencës njëdhimisht keni dhënë çmime joadekuate për këtë pikë. Ne kemi marrë edhe konfirmimin që vërteton këtë pretendim.

d

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.

